



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:150259

Datë: 07.02.2023

Numri i dokumentit: 03949064

CP.nr.168/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC, gjyqtari **Besmir Juniku**, me bashkëpunëtoreshen profesionale Adelina Çmega, në lëndën përmbare të kreditorëve S. H. nga Rahoveci, R. H., K. H., B. H., V. H., që të gjithë nga Prishtina, si dhe T. J. - H., L. J., L. J., V. K., A. J. dhe E. J. që të gjithë nga Rahoveci, të cilët i përfaqëson i autorizuari av. R. K. nga Prizreni, kundër debitorës Gj. D. nga Rahoveci, të cilën e përfaqëson av. D. M. nga Prizreni, duke vendosur lidhur me propozimin për përmbarim në bazë të vendimit gjyqësor, me datë **07.02.2023** merr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorës Xh. D. nga Rahoveci, ashtu që **shfuqizohet** Aktvendimi i kësaj gjykate Ekz.nr.241/06 i datës 12.06.2006 sa i përket kërkesës për rrënimin e pjesës së objektit me etazhitet Su+P+1, i cili prek sipërfaqen prej 43 m², i ndërtuar në parcelën nr.7240-9 ZK Rahovec, përkatësisht në rrugën kaluese e cila ka kufizimet si në vijim: në verilindje kufizohet me parcelën nr.7240-13 në gjatësi prej 55.20m, në juglindje me parcelën nr.7240-12 në gjerësi 4m, në jugperëndim me parcelën nr.7240-9 në gjatësi prej 54.27m dhe në veriperëndim me parcelën nr.8744-0 në gjerësi prej 4m, pjesë e objektit e përshkruar si në skicën e ekspertizës së gjeodezisë së gjeodetit A. M. të datës 16.11.2022 me plotësimet e saj.

ILMBETET NË FUQI pjesa tjetër e Aktvendimit të kësaj gjykate Ekz.nr.241/06 i datës 12.06.2006 me të cilin është lejuar përmbarimi, ashtu që **OBLIGOHET** debitorja Xh. D. nga Rahoveci që të largojë dheun në lartësi prej 3,50m nga pjesa e mbushur e rrugës në gjatësinë prej 36.90m, e cila ndodhet në parcelën nr.7240-9 ZK Rahovec me kufizimet si në vijim: në verilindje me parcelën Nr.7240-13 në gjatësi prej 36.90m, në jug-lindje me parcelën amë në gjerësi prej 4.05m, në jug – perëndim po ashtu me parcelën amë nr.7240-9 në gjatësi prej 26.90m dhe në veri perëndim me parcelën nr.8744-0 në gjerësi prej 4.00m, të cilën e ka mbushur me datë 29.04.2005, po ashtu të ndalojë së penguari në këtë apo në mënyrë tjetër në këtë pjesë të rrugës kreditorët S., R., K., B., V., që të gjithë nga Prishtina, si dhe T. J. - H., L. J., L. J., V. K., A. J. dhe E. J. që të gjithë nga Rahoveci, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktvendimi.

III.Detyrohet debitorja Xh. D. nga Rahoveci që kreditorëve t'ua paguaj shpenzimet e procedurës përbarimore edhe atë shumën e përgjithshme prej 1,872.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktvendimi.

IV.Refuzohet si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesës për kompensimin e shpenzimeve gjyqësore mbi shumën e aprovuar si në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Kreditorët: S. H. nga Rahoveci, R. H., K. H., B. H., V. H., që të gjithë nga Prishtina, si dhe T. J. - H., L. J., L. J., V. K., A. J. dhe E. J. që të gjithë nga Rahoveci, pranë kësaj gjykate me datë 12.06.2006 kanë parashtruar propozim për ekzekutim në bazë të vendimit gjyqësor sipas të cilit kanë kërkuar shfrytëzimin e lirë të rrugës të përshkruar si në vendim gjyqësor të ekzekutueshëm. Kjo gjykatë me Aktvendimin Ekz.nr.241/06 të datës 12.06.2006 e ka lejuar ekzekutimin, ndërsa kundër këtij aktvendimi debitorja brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë me të cilin është lejuar ekzekutimi, me arsyetimin se ky vendim është i ngutshëm dhe i pamatur. Gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë Aktvendim CP.nr.117/2018 të datës 14.07.2020, ndërsa Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë me Aktvendimin CA.nr.5512/20 të datës 20.04.2021 e ka anuluar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje.

Kjo gjykate duke vepruar sipas rekomandimeve të gjykatës së Apelit, me datë 18.07.2022 e deri me datë 25.01.2023 ka mbajtur disa seanca dëgjimore, ka dalë në vend me ekspertët e fushës dhe ka kryer ekspertizat përkatëse të gjeodezisë dhe të ndërtimtarisë.

I autorizuari i kreditorëve av. R. K. nga Prizreni, në seancat dëgjimore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: mbetet pranë propozimit për përbarim sipas Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac.nr.411/05, të datës 12.05.2006, i njëjti ka theksuar se gjendja është ndryshuar nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi. Pas nxjerrjes së këtij aktvendimi kreditorët kanë prova materiale se gjatë zhvillimit të procedurës për pengim posedim, përkatësisht deri sa kjo procedure është vendosur nga Gjykata e Qarkut, me datën 15.05.2006 rruga ka qenë e lirë, me kulturë arë. Andaj, çdo veprim që e ka ndërmarr debitori e ka ndërmarrë pas plotfuqishmërisë të aktvendimit, me qëllim që kreditorëve t'ju vë pengesat për ekzekutimin e aktvendimit të plotfuqishëm. Gjykatës i ka propozuar që ta përbaroj këtë aktvendim, ta detyroj debitorin që në gjatësi të rrugës së shënuar në aktvendim prej 36.9m ta largoje dheun e mbushur në lartësi prej 3.50m, si dhe ta rrënoj pjesën e objektit të ngritur në kuadër të rrugës kontestuese me dimensionet dhe lartësinë e shënuar nga eksperti i ndërtimtarisë, në mënyre që kreditorëve ti lejoje ta shfrytëzojnë rrugën kontestuese për tu kyçur në paluajtshmëritë e tyre të evidentuara si parcelat: nr:7240/14, 7240/12, 7240/11 dhe 7240/10. Gjithashtu ka theksuar se herën e fundit kur gjeometri ka dalë në vend të ngjarjes ka konstatuar se gjatësia e përgjithshme e rrugës është 55.20m, kontesti dhe lloji i kontestit ka qenë pengim posedimi, ndërsa pengim posedimi është bërë në anën e poshtme të rrugës, në kufi me parcelat kadastrale të kreditorëve. Nga gjykata ka kërkuar që ta përbarojë aktvendimin vetëm në atë pjesë që debitorja në cilësinë e të paditurës i ka penguar paditësit në gjatësinë prej 36.90m, në drejtim të rrugës kryesore e shënuar si parcele kadastrale nr.8744, përkitazi me pjesën e rrugës mbi gjatësinë 36.90m deri në gjatësinë 55.20m, në këtë pjesë nuk ka pasur pengim posedim, rruga ka qenë e lire dhe kjo pjesë nuk ka qenë e mbushur me dhe. Ndër të tjera ka theksura se dispozitivi i aktvendimit gjyqësor është i qartë, i kuptueshëm dhe e ka titullin përbarimor në kuptim të nenit 21 të LPP-së. Shpenzimet e

procedurës përbarimore i ka kërkuar në shumën e përgjithshme prej 2,340 euro, duke përfshirë përfaqësim në pesë (5) seanca gjyqësore secila nga 465.00€uro.

I autorizuari debitorës av.D. M. nga Prizreni gjatë seancave dëgjimore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e kundërshtoj në tërësi propozimin për përbarim si të pa bazuar. Rruga në fjalë është e mbyllur me objekt dhe e njëjta as që ka ekzistuar. Tokën në fjalë e ka blerë debitori dhe aty e ka ndërtuar objektin, ndërsa rrugë nuk ka pasur. Objekti në fjalë është ndërtuar menjëherë pas blerjes së tokës përkatësisht rreth vitit 2002 ose 2003. Parcela është blerë pa rrugë dhe për objektin e ndërtimit debitorja ka marr pëlqimin nga organet kompetente dhe e ka ndërtuar. Kjo vërtetohet nga pëlqimin nr.10nr.31 i datës 20.04.2005, i lëshuar nga Drejtoria për Siguri Civile, Emergjencë dhe Mbrojtje të Ambientit-Kuvendi Komunal Rahovec, si dhe Kontrata mbi shitjen e paluajtshmërisë, e legalizuar në gjykatë me numër 459/2005, të datës 18.02.2005. Duke shtuar se në lidhje me deklaratimet e dhëna nga i autorizuari i kreditorëve konsideroj që të gjitha janë supozime të cilat nuk kanë mbështetje në asnjë provë materiale që gjendet në shkresat e lëndës. Sa i përket ekspertizës nga lëmi i ndërtimtarisë, e punuar nga z. Sylejman Daka, për të njëjtën konsideroj që nuk ka peshë dhënia e vërejtjeve ose jo nga debitorja, duke u bazuar në faktin se pjesa e punuar e ekspertizës nuk hynë fare në pjesën e parcelës që është objekt i kësaj çështjeje përbarimore. Meqenëse gjykata me palët në procedurë dhe ekspertin e gjeodezisë kanë dalë në terren, e në bazë të shikimit të drejtpërdrejtë, po ashtu edhe bazuar në fotografitë e bashkëngjitura nga eksperti i gjeodezisë në ekspertizë dhe plotësimin e saj, shihet dhe është e qartë se parcela për të cilën kërkohet ekzekutimi me parametrat e matjes është e lirë dhe e pa penguar nga debitorja. Andaj, krejt në fund gjykatës i propozoj që pas administrimit të provave, propozimin për përbarim ta refuzojë si të pabazuar. Kërkoj shpenzimet procedurale për përfaqësim në dy seanca, secila nga 390.00 euro, në shumën e përgjithshme prej 780.00 euro sipas TA të OAK-së.

Gjykata, pas shqyrtimit të propozimit të kreditorëve, prapësimi të debitorës, si dhe shkresave tjera të lëndës, ka ardhur në përfundim se prapësimi i debitorës **është pjesërisht i bazuar**, duke vendosur si në pikën I të dispozitivit, ndërsa **i pa bazuar në pjesën tjetër** si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata me analizimin dhe shikimin e Aktvendimit C.nr.113/2005 të datës 18.07.2005 të lëshuar nga Gjykata Komunale Rahovec, i cili është ndryshuar me vendimin e gjykatës së shkallës së dytë (Gjykata e Qarkut në Prizren), Aktvendimin Ac.nr.411/05 të datës 12.05.2006, i cili është bërë i ekzekutueshëm me datë 30.05.2006, vërtetoi faktin se këto vendime paraqesin dokument përbarues. LPP në nenin 22 par.1 nënpar.1.1 i cili e përcakton se *” Dokumente përbaruese janë: 1.1. vendimi përbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përbaruese”* dhe neni 24 par.1 *” Vendimi gjyqësor,... është i përbarueshëm po që se ka marrë formën e prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushje ”*. Sipas vendimeve gjyqësore të potencuara që i janë bashkëngjitur propozimit për përbarim, gjykata gjeti se të njëjtat janë në formatin origjinal dhe ka cilësinë e dokumentit përbarues, janë të përshtatshme për përbarim sepse në to janë të përcaktuar saktë kreditorët dhe debitori, si dhe urdhëri për largimin e dheut dhe ndalimin e pengimit të kreditorëve në atë pjesë të rrugës. Po ashtu është e përcaktuar edhe koha e përmbushjes së detyrimit nga debitorja. Gjykata, duke vepruar sipas rekomandimeve të gjykatës së shkallës së dytë ka nxjerrë shkresat e lëndës C.nr.113/05 sipas të cilave rezulton se vendimet gjyqësore janë në formatin origjinal dhe e kanë cilësinë e dokumentit përbarues. Gjykata ka dalë në vend dhe me ekspertin e gjeodezisë ka bërë identifikimin e rrugës në gjatësi prej 36.90m në të cilën ka ndodhur pengim posedimi, ku me rastin e daljes në vend gjykata ka pa se dheu është ende në atë pjesë, pra nuk është larguar. Sipas ekspertizës së gjeodezisë të datës 19.12.2022 me plotësimet e saj të datës 04.01.2023 dhe sqarimet e ekspertit

në seancë, gjykata vjen në përfundim se rruga ku ka ndodhur pengim posedimi është në gjatësi prej 36.90m, (si në Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.411/05 të datës 12.05.2006) ka kufizimet si në ekspertizë të gjeodezisë, ku në këtë pjesë ende ekziston dhe, për çka rezulton se debitorja deri më tani nuk ka vepruar sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm. Ndërsa pjesa ku ndodhet objekti me etazhitet Su+P+1, i cili prek sipërfaqen prej 43 m², i ndërtuar në parcelën nr.7240-9 ZK Rahovec, nuk e prek rrugën ku ka ndodhur pengim posedimi. Pra kjo pjesë e rrugës ku është ndërtuar objekti nuk hyn fare në pjesën e rrugës në gjatësi prej 36,90m, aty ku ka ndodhur pengim posedimi, e që është në vendimin gjyqësor për tu përmbaruar. Sipas ekspertizave të gjeodezisë dhe ndërtimtarisë është dhënë përgjigje edhe në pyetjen se kur është ndërtuar objekti i potencuar, e që rezulton të jetë periudha prej shtator 2005-2008. Me analizimin e shkresave të lëndës C.nr.113/05, çështja kontestimore me bazë juridike pengim posedimi e zhvilluar në këtë gjykatë, rezulton se nga data 26.05.2005 e deri me datë 14.09.2005 (data kur kreditorët kanë parashtruar përgjigje në ankesë) nuk ka qenë objekti duke u ndërtuar, sepse në përgjigje në ankesë paditësit – kreditorët nuk e kanë përmendur objektin. Pra, në këtë periudhë ka qenë duke u zhvilluar kontesti lidhur me pengim posedimin për shkak të vendosjes së dheut në rrugën kaluese. Pas datës 14.09.2005 rezulton se është ndërtuar objekti dhe i njëjti është përfunduar pa iniciuar asnjë procedurë tjetër nga ana e kreditorëve/paditësve. Nëse kreditorët janë penguar për të kaluar në rrugën përkatëse, me rastin e ndërtimit të objektit, të njëjtit është dashtë që të iniciojnë procedurë tjetër kontestimore për atë pjesë të rrugës ku janë cenuar apo të propozojnë masë të sigurisë: ndalim të ndërtimit të objektit. Këto mundësi ligjore kreditorit/paditësit nuk i kanë shfrytëzuar.

Gjykata sipas dokumentit përmbarues vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorës dhe duke e shfuqizuar Aktvendimin e kësaj gjykate Ekz.nr.241/06 i datës 12.06.2006 sa i përket kërkesës për rrënimin e pjesës së objektit me etazhitet Su+P+1, i cili prek sipërfaqen prej 43 m² në pjesën e përshkruar si në pikën I të dispozitivit (ekspertiza), me arsyetimin se ky objekt dhe kjo pjesë e rrugës nuk i përket dispozitivit të vendimit gjyqësor i cili kërkohet që të përmbarohet. Gjykata në procedurë përmbarimore e bën përmbarimin në bazë të dispozitivit të vendimit gjyqësor, e që në këtë rast pjesa e rrugës ku ndodhet objekti i cili kërkohet të rrënohet nuk është rruga e mbuluar me dhe e përshkruar në vendimin gjyqësor. Kjo është sqaruar me ekspertizën e gjeodezisë në lidhshmëri edhe me atë të ndërtimtarisë. Për këto arsye pjesa e propozimit për përmbarim me të cilën është kërkuar rrënimi i objektit, përkatësisht në atë pjesë ku preket rruga kaluese është i pathemeltë.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke e lënë në fuqi pjesën tjetër të Aktvendimit të kësaj gjykate Ekz.nr.241/06 i datës 12.06.2006, duke e obliguar debitorin Xh. D. nga Rahoveci që të largojë dheun në lartësi prej 3,50m nga pjesa e mbushur e rrugës në gjatësinë prej 36.90m, me kufizimet e përshkruara si në dispozitiv të këtij aktvendimi, me arsyetimin se Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.411/05 të datës 12.05.2006 është i formës së prerë, i ekzekutueshëm dhe është dokument përmbarimor. Debitorja nuk e ka përfillë këtë vendim, pra edhe pas kalimit të afateve për përmbarim, nuk e ka larguar dheun nga ajo pjesë, e që rezulton se tani duhet ta largojë dhe të përmbarohet largimi i dheut, e që kjo do të bëhet me ngarkim të të gjitha shpenzimeve në barrë të debitorës. Gjykata me analizimin e ekspertizës së gjeodezisë, duke u bazuar edhe në shkresat e lëndës C.nr.113/05, ka ardh në përfundim se pjesa e rrugës që ka ndodhur pengim posedimi dhe ku është urdhëruar largimi i dheut është pjesa e përshkruar si në pikën II dhe se në këtë pjesë nuk ka kurrfarë objekti që duhet të rrënohet, prandaj përmbarimi lejohet vetëm në këtë pjesë sa i përket largimit të dheut, ashtu siç është e përshkruar në vendim gjyqësor. Në procedurën përmbarimore gjykata është e lidhur për dokumentin përmbarimor, në këtë rast për ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Gjykata nuk mund të dalë jashtë kornizave të këtij vendimi, pra të përmbarojë urdhëresa që nuk i përkasin

dispozitivitet të vendimit gjyqësor, e që në këtë rast urdhëresa për rrënim të objektit nuk i përket dispozitivitet të vendimit gjyqësor si dokument përmbarues.

LPP në nenin 27 par.1 e përcakton se *”Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, Neni 36 par.1 *”Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar...”*.

Vendimet në fjalë janë dhënë në procedurë gjyqësore, të njëjtat kanë marrë formën e prerë me datë 30.05.2006 dhe se i përmbushin të gjitha kushtet ligjore konform nenit 22 par.1 nënpar.1.1, nenit 23 par.1 dhe nenit 24 par.1 të LPP-së.

Gjykata analizoi edhe pretendimet e debitores e cila ka theksuar se në atë pjesë nuk ka pasur asnjëherë rrugë kaluese, e që kjo bie në kundërshtim me vendimet gjyqësore të cilat janë dokumente përmbaruese, sipas të cilave është vërtetuar se me datë 29.04.2005 ka ndodhur pengim posedimi në pjesën e rrugës si në pikën II të dispozitivitet, ku debitorja ka vendosur dheun në atë pjesë, ndërsa gjykata ka urdhëruar largimin e dheut. Deri më sot debitorja nuk e ka larguar dheun, pra nuk ka vepruar sipas vendimit gjyqësor. Pretendimet se objektin në fjalë e ka ndërtuar në vitin 2002 janë deklarative dhe nuk kanë impakt në vendosjen ndryshe nga pika I e dispozitivitet të këtij aktvendimi, me arsyetimin se ky objekt nuk hyn fare në pjesën e rrugës ku duhet të kryhet përmbarimi.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivitet të këtij aktvendimi, konform nenit 13 par.4 lidhur me nenin 17 të LPP-së dhe nenin 452 të LPK-së si dhe Tarifën e OAK-së, duke e obliguar debitorin në pagesën e shpenzimeve të procedurës përmbarimore: shumën prej 1,872.00 Euro në emër të përfaqësimit në 4 seanca gjyqësore , secila nga 468.00 euro. Pjesën tjetër të kërkesës për shpenzime gjykata e ka refuzuar për shkak se në këtë çështje përmbarimore janë mbajtur 4 seanca në të cilat ka përfaqësuar avokati sipas autorizimit.

Nga ajo që u tha më lartë, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 22 par.1 nënpar.1.1, neni 24 par.1, 27 par.1, 36 par.1, neni 109 par.3, neni 69,71,73, neni 17, dhe neni 77 par.1 dhe 5 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore dhe neni 452 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga ajo që u tha më lartë, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 22 par.1 nënpar.1.1, neni 23 par.1, 24 par.3, neni 27 par.1, neni 71,73 neni 77 par.1, 290 par.2, dhe neni 293 par.1 dhe 3 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
CP.nr.168/2021, me datë 07.02.2023.

B. Profesionale
Adelina Çmega

Gj y q t a r i,
Besmir JUNIKU

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.